

Veprimtaria e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit i nënshtrohet kontrollit financiar nga auditi i brendshëm pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Njëkohësisht, IKMT kontrollohet edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm, i cili kontrollon përdorimin efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, mirëadministrimin financiar dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare si dhe kontrollin nga Inspektorati i Përgjithshëm, çka synon forcimin e transparencës, rritjen e llogaridhënies dhe garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së IKMT-së në përputhje të plotë me standardet ligjore dhe institucionale.